

**K O N K L U Z I O N**  
**Nr.08- 1125/1 dt. 02.12.2013**  
**PËR SHPALLJE TË PËRFUNDIMIT PËR VERIFIKIMIN**  
**E PROJEKTBUXHETIT TË KOMUNËS DIBËR PËR VITIN 2014**

**113.**Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),

Kryetari i Komunës Dibër:

**K o n k l u d o i**

SHPALLET përfundimi për verifikimin e projektbuxhetit të Komunës Dibër për vitin 2014, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e tetë dt.29.11.2013.

**KOMUNA DIBËR**  
**Kryetari,**  
**Ruzhdi Lata d.v.**

**P Ë R F U N D I M**  
**Nr. 07-1097/3 dt. 29.11.2013**  
**PËR VERIFIKIMIN E PROJEKTBUXHETIT**  
**TË KOMUNËS DIBËR PËR VITIN 2014**

**114.**Në mbështetje të nenit 36 paragrafi 1 pika 2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale („Gazeta zyrtare e RM,, nr.5/02) si dhe nenit 27 paragrafi 1 pika 4 të Statutit të komunës („Kumtesa Zyrtare e Komunës,, nr 14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 8<sup>te</sup> datë 29.11 .2013 përfundoi:

- 1.Verifikohet projektbuxheti i Komunës Dibër për vitin 2014.
- 2.Të gjitha vërejtjet rreth Projektbuxhetit të komunës Dibër për vitin 2014 të dhëna gjatë shqyrtimit publik do të jenë pjesë përbërëse e tekstit të Buxhetit i cili do të përgatitet si propozim buxhet që do t'i dërgohet Këshillit të Komunës për miratim.
- 3.Ky përfundim hyn në fuqi një ditë pas shpalljen në “Kumtesën zyrtare të Komunës”

**KËSHILLI I KOMUNËS**  
**Kryetari,**  
**Bashkim Mashkulli d.v.**

**K O N K L U Z I O N**  
**Nr.08- 1125/2 dt. 02.12.2013**  
**PËR SHPALLJE TË PËRFUNDIMIT PËR SJELLJEN E**  
**PROGRAMIT PËR MIRËMBAJTJEN**  
**E RRUGËVE KOMUNALE DHE RRUGICAVE NË KOMUNËN DIBËR**  
**PËR VITIN 2013/2014 NË KUSHTE DIMËRORE**

**115.**Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),  
Kryetari i Komunës Dibër:

**K o n k l u d o i**

SHPALLET përfundimi për sjelljen e programit për mirëmbajtjen e rrugëve komunale dhe rrugicave në Komunën Dibër për sezonin 2013/2014 në kushte dimërore, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e tetë dt.29.11.2013.

**KOMUNA DIBËR**  
**Kryetari,**  
**Ruzhdi Lata d.v.**

**P Ë R F U N D I M**  
**Nr. 07-1097/4 dt. 29.11.2013**  
**PËR SJELLJEN E PROGRAMIT PËR MIRËMBAJTJEN**  
**E RRUGËVE KOMUNALE DHE RRUGICAVE NË KOMUNËN DIBËR**  
**PËR VITIN 2013/2014 NË KUSHTE DIMËRORE**

**116.**Në mbështetje të nenit 36 paragrafi 1 pika 7 të Ligjit për vetqeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 59 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),  
Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 8<sup>të</sup> dt. 29.11.2013 përfundoi:

1. Këshilli i Komunës Dibër solli Programin për mirëmbajtjen e rrugëve komunale dhe rrugicave në Komunën Dibër për sezonin 2013/2014 në kushte dimërore, me këto plotësime:
  - Në prioritetin e parë të hyn dhe rrjeti i rrugëve lokale të këtyre vendbanimeve, f.Kosovrast i Epërm, f. Mogorçë, f.Banisht dhe f. Otishan.
  - te tabela e rrugëve të prioritetit të dytë të hiqen rrugët lokale të venbanimeve të lartëpërmendura dhe të shtohet rruga për f. Bomovë.
- 2.Programi nga pika 1 është pjesë përbërëse e përfundimit.
- 3.Ky përfundim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të shpallet në “Kumtesën zyrtare të Komunës”

**KËSHILLI I KOMUNËS**  
**Kryetari,**  
**Bashkim Mashkulli d.v.**

Në mbështetje të nenit 14 alinea 8 , nenit 15 alinea 1 pika 18 të Ligjit për rrugë publike ("Gazeta zyrtare e RM " nr. 84/08 , 52/09 , 114/09 , 124/ 10 , 23/11, 53/11, 44/12,168/12 dhe 163/13, ) nenit 2 të Ligjit për pastërti publike ("Gazeta zyrtare e RM " nr 111/08, 64/09, 88/10, 114/10, 23/11, 53/11, 80/12 dhe 163/13 ), nenit 9 të Ligjit për mbrojtje dhe shpëtim ("Gazeta zyrtare e RM" nr.36/04,49/04,86/08,124/10 dhe 18/11) nenit 5 të Ligjit për menaxhim me kriza ("Gazeta zyrtare e RM nr 29/05 dhe 36/11) dhe nenit 59 të Statutit të Komunës Dibër ("Kumtesa zyrtare e komunës Dibër " nr 14/03),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën 8<sup>të</sup> dt. 29.11.2013 solli :

## **PROGRAM**

### **PËR MIRËMBAJTJEN E RRUGËVE KOMUNALE DHE RRUGICAVE NË KOMUNËN DIBËR PËR VITIN 2013/2014 NË KUSHTE DIMËRORE**

#### **I Pjesa e përgjithshme**

Me këtë program rregullohen punët për mirëmbajtjen e rrugëve komunale dhe rrugicave, pjesët e rrugëve rregjionale të cilat kalojnë nëpër vendbanime dhe janë të ndërtuara si rrugë, si edhe punët për mirëmbajtjen e objekteve komunale, trotualet në territorin e Komunës Dibër për sezonin 2013/2014 .

Rrugë publike në territorin e komunës Dibër janë rrugët komunale dhe rrugicat. Në rrugët hyejnë dhe pjesët e rrugëve rregjionale të cilat kalojnë në vendbanimet si rrugë të ndërtuara .

Punët për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve komunale dhe rrugicave janë :

-pastrimi i borës dhe akullit nga rrugët , objektet komunale dhe trotualet .

-shtrimi i rrugëve me krypë ose elementeve abrasive në pjesët e rrugëve ku nuk ka diell, urat, pjesët e rrugëve të cilat kanë pjertësi si dhe vende të tjera ku paraqitet akull në rrugë .

Punët për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve komunale dhe rrugicave realizohen në mënyrë që të sigurohet kalueshmëri e vazhdueshme, varësisht nga prioriteti i përcaktuar që del nga kategoria dhe rëndësia e rrugëve komunale dhe rrugicave.

Me përjashtim, kur punët në rrugët komunale dhe rrugicat nuk mund të realizohen, sektori për urbanizëm, mbrojtje të ambientit, zhvillim ekonomik lokal,veprimtari komunale,komunikacion dhe rrugë pranë Komunës Dibër, përkohësisht, pjesërisht ose në tërësi do ta ndalojë komunikacionin dhe do të përcaktojë në cilën rrugë tjetër dhe në bazë të cilave kushte do të realizohet komunikacioni, me lajmërim paraprak të shfrytëzuesve të rrugës publike dhe rrugicave në afat prej 48 orë nëpërmjet mjeteve të informacionit.

Nëse për shkak të borës , akullit ose arsyeve të tjera komunikacioni në rrugën komunale ose rrugicë vështirësohet ose siguria e komunikacionit në pjesë të madhe është rrezikuar, shërbimi komunal kompetent do të merr masa urgjente për eliminimin e pengesave, e nëse nuk është në gjendje t'i eliminojë pengesat, do ta ndalojë komunikacionin në tërësi ose për disa lloje të makinave, me pëlqim paraprak të Ministrisë së Punëve të Brendshme respektivisht organit kompetent të komunës .

Në rastet kur ndërprerja e komunikacionit zgjat më shumë se dy orë, organi kompetent i komunës duhet të lajmërojë opinionin nëpërmjet mjeteve të informacionit

Organi kompetent i komunës me shenja komunikacioni dhe mënyra tjera adekuate do të shënojë kushtet dhe do të përcaktojë rregjim të komunikacionit në rrugë komunale dhe rrugica, në të gjitha rastet kur ekzistojnë rrethana të cilat mund të rrezikojnë zhvillimin e sigurt të komunikacionit.

Në rast të ndërprerjes së komunikacionit në rrugë publike për shkak të fatkeqësive elementare (orteqe të borës , rëshqitje ose arsye tjera ) organi kompetent i komunës do të veprojë në përputhje të një plani të veçantë për largimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore, të cilin e sjell Këshilli i Komunës .

## **II. Organizimi**

Në mirëmbajtjen dimërore të rrugëve komunale dhe rrugicave do të marrin pjesë : organet kompetente komunale dhe realizuesi i cili paraprakisht duhet të zgjidhet sipas procedurës me tender , konform kontratës së arritur për mirëmbajtjen e rrugëve komunale dhe rrugicave:

### **1.Këshilli i komunës Dibër**

- sjell program për mirëmbajtje dimërore ;
- sjell plan të veçantë për largimin e pasojave nga fatkeqësitë elementare .

### **2.Sektori për urbanizëm, mjedis dhe zhvillim ekonomik lokal, veprimtari komunale , komunikacion dhe rrugë :**

-Organizon pastrimin e borës dhe ngricave nga rrugët komunale, objektet komunale dhe trotuarët si dhe bën shtrimin i rrugëve me krypë ose elemente abrasive;

-përkohësisht , pjesërisht ose në tërësi bën ndalimin e komunikacionit kur punët nuk mund të kryhen për zhvillim të trafikut dhe vendos nga cila rrugë tjetër dhe në cilat kushte do të realizohet komunikacioni;

-në afat prej 48 orësh para ndalimit të komunikacionit i njofton shfrytëzuesit të rrugëve komunale dhe rrugicave nëpërmjet mjeteve të informacionit publik .

-ndërmer masa emergjente , për largimin e pengesave që rrëndojnë zhvillimin e komunikacionit dhe rrezikojnë sigurinë e komunikacionit ose ndalon komunikacionin në disa rrugë ose në përgjithësi paraprakisht me marrjen e lejes nga organi shtetëror ose komunal përkatës;

-njofton publikun nëpërmjet mjeteve të informacionit për ndërprerjen e komunikacionit më gjatë se dy orë ;

-vepron konform planit të veçantë për largimin e pasojave nga fatkeqësitë elementare në raste të ndërprerjes së komunikacionit për shkak të fatkeqësive natyrore;

### **3 Inspektori Komunal**

- bën mbikqyrje dhe kontroll të pastrimit të sipërfaqeve publike në kushte dimri.

### **4.Shtabi komunal për mbrojtje dhe shpëtim :**

-në mënyrë aktive merr pjesë në përgatitjen e programit, ndjekjen dhe zbatimin e tij, ndjek situatën e përgjithshme në periudhën dimërore me qëllim të marrjes së masave adekuate për mbrojtje dhe shpëtim si dhe aktivitete konkrete për trajnim dhe përgatitje të ekipeve - personave që do të bëjnë pastrim dhe kryposje .

Në mirëmbajtjen dimërore të rrugëve dhe rrugicave do të marrin pjesë edhe organe, institucione dhe ndërmarrjet e tjera me detyra si vijojnë :

#### **1.Inspektori shtetëror për rrugë,**

-bën mbikqyrje dhe kontroll të masave dhe aktiviteteve për sigurinë e komunikacionit nëpër rrugë .

#### **2.Qendra rregjionale për menaxhimin me kriza:**

-Bashkangjitet në realizimin e programit tek pjesa e sistemit informativ për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve, edhe atë vetëm me ndihmesë të rrjetit të radiostacioneve në territorin e komunës .

#### **3. Policia e rrugore**

-përvec detyrave që ka nga kompetenca saj, ajo është burimi i parë i informatave nga terreni për gjendjen e rrugëve.

#### **4. Ndërmarrja publike për mirëmbajtjen e rrugëve ,, Makedonija Pat ,, Shkup njësia Dibër .**

-Realizon programin në tërësi të pjesa e rrugëve që kanë karakter rregjional sipas procedurës për mirëmbajtje dimërore të rrugëve magjistrale dhe rregjionale .

## Nr.8/02.12.2013 KUMTESA ZYRTARE E KOMUNËS faq.172

-Ndërmarrja publike për mirëmbajtjen e rrugëve „ Makedonija Pat „, në bazë të programit për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve magjistrale dhe rregjionale ka për detyrë të realizojë mirëmbajtje dimërore të rrugëve tranzite edhe atë tek konstrukcioni rrugor dhe sinjalizimi rrugor që është në funksion në rrugët rregjionale publike dhe atë te:

-Rrugën „8 Shatatori „nga hyrja në qytet deri tek udhëkryqi (rrethi ), vazhdon në rrugën „ 100,, , rrugën „, Beton,, , rrugën „, Amdi LLeshi „, , rrugën „, 22 Dhjetori,, dhe dalje nga qyteti në drejtim të pikës kufitare Bllatë .

-Nga udhëkryqi (rrethi ) tek rruga „, Velko Vllahovic,, deri në dalje të qytetit në drejtim të rrugës për në Strugë .

Për arsye të efektit veprues të programit duhet të mirren parasysh edhe momentet që vijojnë :

- 1- shkalla e gatishmërisë
- 2- përparësitë e zbatimeve
- 3- mbykëqyrja dhe informimi
- 4- përdorimi e makinerisë
- 5 -përdorimi i punës së dorës
- 6- financimi i programit

### III- Shkalla e përgatitjes

Kriteri i shkallës së përgatitjes është situatë e krijuar kohore e cila për çdo ditë përcillet me anë të mjeteve të informacionit .

Parapërgatitja fillon më 15 nëntor për çdo vit kalendarik dhe mbaron më 15 mars të vitit në vijim .

Shkallën e përgatitjes do t'a vlerësoj Këshilli i komunës dhe këshilli për sigurimin e komunikacionit .

Sipas situatës së krijuar në atë periudhë kemi 3 shkallë të gatishmërisë dhe ata janë :

#### Shkalla e parë :

Kalendarisht ka filluar sezoni dimëror mirëpo situata ditore e komunikacionit dhe komunikimeve është normale .

Në pikat (puktet) gjithçka është në rregull, për sasinë e krypës dhe rrërsë së imët duhet të realizohet shpallje për furnizim publik , ndërsa mekanizimi teknik është në rregull. Sasia e nevojshme e krypës është 30 tonelata, ndërsa e rrërsë së imët është përafërsisht 90 m3, sasi të cilat janë të mjaftueshme për mirëmbajtjen e rrugëve dhe rrugicave në kushtet dimërore .

#### Shkalla e dytë

Ndodh kur kemi ulje të temperaturave dhe priten rreshje të dëborës. mirren masa preventive për hudhjen e krypës .

Ndërmerren masa preventive për shtrimin e rrugëve dhe rrugicave me prioritet të parë me krypë .

Kjo shkallë me përparësi fillon me fillimin e të reshurave të dëborës , por ato mund të eliminohen edhe me mekanizimin përkatës të përfshirë në planin e veprimit.

#### Shkalla e tretë

Fillon kur të reshurat e borës dhe rasteve të tjera nuk mundin të eliminohen me mekinerinë disponuese dhe resurset njerëzore të përfshirë në planin e veprimit.

Aktivizohet shtabi i Agjensionin për menaxhim me kriza dhe në mënyrë të koordinuar veprohet për ëmbëlsimin e kushteve të kohës .

#### Përparësitë për veprim

Për arsye të rëndësisë se objekteve komunale inponohen dhe përparësia e veprimit në kushte dimërore. Nëse, shikuar nga aspekti i shkaqeve ekonomike, nuk është e pranueshme dhe mënyrë të plotë, mirëmbajtja e rrjetit të rrugëve të qytetit dhe disa pjesëve të rrugëve lokale, atëherë rrjeti rrugor dhe rrugët lokale do t'i rangojmë me qëllim të intervenimit prioritar dhe për zbutjen e kushteve dimërore .

**A/Prioriteti i parë**

Kur kushtet dimërore paraqesin cënim të komunikacionit në periudhën dimërore, veprohet në këtë mënyrë :

Hudhje paraprake të krypës që të pengohet formimi i akullit, e nëse ajo paraqitet vazhdohet me hudhje të rregullt të krypës dhe rrës deri në eliminimin e saj.

Kur në mënyrë intensive kemi rreshje dëbore, akulli duhet patjetër që të largohet nga rruga dhe të bëhet transportimi i tij deri tek vendi i deponisë i cili ndodhet në dalje të qytetit .

Pastrimi i rrugëve realizohet në gjërësi deri në 2,5 m në një korsi të rrugës ashtu që pastrimi në dy korsi është 5,0 m .

Pastrimi të realizohet më së shumti për tetë orë nga ndërprerja e rreshjeve . Në rrugët të cilat me plan operativ janë të vendosura në prioritetin e parë , komunikacioni do të realizohet me shpejtësi të kufizuar konform Ligjit për siguri të komunikacionit dhe ligjit për rrugët .

Në prioritetin e parë hyjnë objektet me gjatësi 35.300 km .

**B/Prioriteti i dytë**

Gjërësia e rrugës të pastruar në një drejtim do të jetë 2. 0 m , në dy drejtimet gjërësia e rrugës është 4.0 metra, gjithashtu në ç' do 50 -100 m do të bëhet zgjerim për tejkalim të makinave .

Rrugët e ngushta pastrohen në gjërësi prej 2. 5 m në lentat e rrugëve pastrimi do të realizohet më së voni për 12 orë nga ndërprerja e të rreshurave .

Rruga e pastruar duhet të jetë e përgatitur për komunikacion me shpejtësi të zvogëluar , përkohësisht bëhet lëshimi i krypës për arsye të paraqitjes së akullit , nëse ajo krijohet vazhdohet me lëshimin e krypës dhe rrës deri tek eliminimi i saj.

Komunikacioni mund të ndërpritet në koordinim me policinë rrugore ndërsa makinat drejtohen në rrugë tjetër deri në pastrimin e vendit kritik .

Në prioritetin e dytë hyjnë rrugët me gjatësi të përgjithshme prej 34.550 km.

Në prioritetin e dytë e fusim edhe rrjetin e rrugëve lokale me shfrytëzimin e mekanerive përkatëse të cilat janë në përdorim për pjesën e qytetit edhe ate në raste kur ato janë të lira, në të kundërt aktivizohen kontratat dhe operativat ndërtimore sipas planit operativ .

Gjatësia e rrjetit e cila mirëmbahet është 67.085 km.

**V/Prioriteti i tretë**

Në prioritetin e tretë hyjnë të gjithë rrugët e tjera të qytetit ku hyrja e makinerisë është e pamundshme dhe të njejtët do të pastrohen me intervenimin e qytetarëve dhe koordinim të bashkësive lokale .

**IV-Inspektimi dhe informimi.**

**Inspektimi.**

Kontrolli në teren do të realizohet me makina zyrtare me të cilat disponojnë grupet që janë të kyqura në shërbimin dimëror, në raste më të vështira shfrytëzohen makinat e tereneve të Shtabit për mbrojtje civile si dhe të komunës Dibër, ndërsa informacionet do të pranohen nga grupet e njejtë si edhe nga organi i Ministrisë së Punëve të Brednëshme. Inspektimi do të realizohet në rrjetin e rrugëve lokale për arsye të largësisë të rrugëve, ndërsa në vendet urbane të njejtën punë do ta realizojnë personat përgjegjës të shërbimit dimëror. Të njejtët persona detyrimisht punojnë në koordinim me policinë rrugore .

**Informimi**

Nga grupi operativ i cili është në teren duke shfrytëzuar informacionet nga mjetet e informimit publik si edhe shërbimit të MPB, njohtohet Këshilli i komunës i cili në të njejtën kohë koordinon me Shtabin për Mbrojtje Civile si edhe Qendrën për Njohtim dhe Alarm , ndërsa në të njejtën kohë për vijimin e punës do të njohtohen edhe organet për sigurimin e komunikacionit për kyqjen eventuale të tyre për intervenim si edhe Shoqata Auto Moto e Maqedonisë (AMCM).



## V. Shfrytëzimi i makinerive

Në planin për mirëmbajtje dimërore do të përfshihen makinat më të nevojshme me të cilat do të mposhten fatkeqësitë natyrore në suazat e kushteve normale dimërore, në të kundërtën do të angazhohen mjete të rënda plotësuese mekanike në koordinim me Shtabin për Mbrojtje Civile .

Për pjesën e qytetit janë në disponim këto makina : traktor për ngarkesë, kamion me plug dhe shpatull krye dhe makinë univerzale për ngarkesë ICB.

Për angazhimin e operativës ndërtimore do të shpallet furnizim publik për pjesëmarje të tyre me makineri.

## VI- Përdorimi i krahut të punës .

Për territorin e qytetit, Komuna Dibër do të angazhojë një vozitës , sipas nevojës edhe punëtorë fizik dhe një përgjegjës. Të njejtët do angazhohen sipas planit operativ për mirëmbajtjen e rrugëve komunale në kushte dimërore .

Në mirëmbajtjen dimërore të rrugëve lokale , rrugicave dhe objekteve të ndryshme komunale do të kyqen dhe :

1.EVM Maqedoni dega Strugë.

-I ndërmerr masat e nevojshme për pastrimin e dëborës nga elektroinstalimet e jashtme, hyrjet dhe rrethinat e tranfostacioneve dhe orendive të ndryshme .

2.SHA,,Telekomunikacioni i Maqedonisë,, qendra regjionale e telekomunikacionit Dibër.

-merr masat e nevojshme për pastrimin e borës nga instalimet dhe orenditë e jashtme të PTT.

3. Transportuesit në trafikun publik

- marrin masa për largimin e dëborës dhe akullit nga stacionet e autobusëve dhe aftësimin e tyre.

4. Qytetarët

- pastrojnë borën dhe akullin nga trotuarët, rrugicat dhe hyrjet para ndërtesave banuese dhe shtëpive individuale, gjithashtu pastrojnë çatitë dhe terasat duke u kujdesur për sigurinë e kalimtarëve dhe duke mundësuar qarkullim normal dhe të sigurtë të këmbësorëve dhe komunikacionit tjetër.

5. Pronarët dhe shfrytëzuesit e objekteve afariste dhe shitoret.

-pastrojnë dëborën dhe akullin nga trotuarët dhe hyrjet para objekteve të tyre afariste dhe shitoreve duke pasur parasysh sigurinë e kalimtarëve për të mundësuar lëvizjen e sigurtë dhe normale të tyre dhe të komunikacionit tjetër .

6. Pjesëmarrës të tjerë .

-njësitë të sektorit për mbrojtje dhe shpëtim , bashkësitë lokale , nxënësit, studentët e të tjerë, në rastet e paraqitjes të fatkeqësisë elementare, në mënyrë të përbashkërt veprojnë sipas planit për largimin e pasojave nga fatkeqësitë elementare , miratuar nga ana e Këshillit të komunës.

7. Bashkësitë urbane dhe lokale të komunës.

-janë të detyruar të marrin masa edhe atë : të njohtojnë organet përkatëse dhe qytetarët për gjendjen e krijuar , nevojën dhe mënyrën e largimit të orteqeve nga bora , të angazhojnë qytetarët e bashkësive lokale që në mënyrë të kontraktuar me komunën Dibër - sektorin për urbanizëm, mbrojtje të ambientit, zhvillim ekonomik lokal, veprimtari komunale,rrugë dhe komunikacion të marrin angazhime konkrete pune dhe obligime në mirëmbajtjen dimërore , ndërsa disa bashkësi lokale munden të deponojnë, rruajnë dhe përdorin sasi të caktuara të krypës me mundësi të përdorimit të makinerive dhe ekipeve vetanake për pastrim dhe kryposje .

8.Të gjithë pjesëmarrësit në kryerjen e punëve të marra për mirëmbajtjen dimërore të rrjetit rrugor janë të obliguar pranë organit kompetent komunal të dorëzojnë program operativ për përgatitjen dhe paisjen me makineri dhe njerëz .

## VI-Financimi

Me Programin për 2013/2014 planifikojmë të janë të nevojshme 2.400.000,00 denarë dhe atë :

-përdorimi i makinave \_\_\_-\_\_\_\_\_ denarë (amortizimi, pjesë rezerva )

-shërbime nga operativa tjetër \_\_\_\_\_-\_\_\_\_\_ denarë .

-punë dore ( kujdestari dhe rrogë e rregullt ) \_\_\_\_\_-\_\_\_\_\_ denarë .

## Nr.8/02.12.2013 KUMTESA ZYRTARE E KOMUNËS faq.175

-materiale (rrrë , krypë , asfalt i ftohtë etj )\_\_\_\_\_ -\_\_\_\_\_ denarë

Mjetet do të sigurohen nga buxheti i Komunës Dibër .

Shpenzimet reale do të përcaktohen pas përpilimit të librit ndërtues verifikuar nga person i autorizuar i pushtetit vendor e pastaj do të shpenzohen mjetet për mirëmbajtjen dimërore .

### VII PLANI OPERATIV

Stacionimi i njerëzve dhe makinerisë do të jetë në hapësirat e ndërtesës Komunale, materiali abraziv do të jetë i deponuar në garazhat e hapësirës të Gazermës, ndërsa marrja e informacioneve dhe njohtimet do të merren në tel. 831 -196.

Aktivizimin e parë të gjithë grupit të inkuadruar në mirëmbajtjen dimërore me leje të Kryetarit të komunës, do ta kryejë referenti Besnik Kaziu dhe vozitësi Eshtref Paçuku. Vazhdimi i mëtutjeshëm i veprimit të grupit operativ do të jetë sipas planit operativ dhe në përgjegjësinë e drejtpërdrejt të Besnik Kaziu dhe Eshtref Paçuku.

### Prioriteti i parë

Vendet kritike ku duhet të kushtohet vemendje e veçantë :

- pastrimi me kamion me plug dhe derdhja e rizllës me krypë

Nr.	Emri i rrugës	Gjatësia
1	Rr. "8- Shtatori "	800
2	Rr ,, Bashkim Vëllazërim ,,	440
3	Rr ,, Atanas Iliç,,	600
4	Rr.,,Urfi Agolli ,,	290
5	Rr.,,Zija Mersoski,,	330
6	Rr.,, Proleterska ,,	340
7	Rr.,,Leninova,,	400
8	Rr.,,Mosha Pijade,,	250
9	Rr.,,11- Tetori,,	270
10	Rr ,,Nikola Tesla,,	200
11	Rr.,,4- korriku ,,	140
12	Rr.,,200,,	350
13	Rr.,,201,,	340
14	Rr.,,202,,	900
15	Rr.,,204,,	320
16	Rr ,,205,,	570
17	Rr.,,206,,	310
18	Rr.,,Batajoni rrinor Dibran,	330
19	Rr.,,Bulevardi Shkupi ,,	540
20	Rr.,,307,,	140
21	Rr.,,Partizanska,,	950
22	Rr.,,1 Maji,,	920
23	Rr.,,Edvard Kardel,,	750
24	Rr.,,Ice Risteski,,	560
25	Rr.,,Skopska,,	400
26	Rr.,,Eqerem Zengo,,	940
27	Rr.,, Korpusi i 15-të,,	850
28	Rr.,,Ali Zengoski,,	1330
29	Rr.,,Xhavit Ushtelena,,	1200
30	Rr.,,Jordan Zafirovski,,	250
	GJITHSEJ	17.100

Pastrimi me ICB makinë pa hudhje.

Nr	Emri i rrugës	Gjatësia
1	Rr ,, Drini i Zi ,,	425
2	Rr ,, Angele Oboçki ,,	200
3	Rr ,, Zdravko Çoçkovski ,,	590
4	Rr Ibe Palikuqi,,	320
5	Rr,, Petre Popovski ,,	650
6	Rr ,, APJ”	960
7	Rr."Ibrahim Kolari"	1000
8	Rr."Dilaver Sela"	1110
9	Rr."Pavle Xhikovski"	680
	Gjithsej	5.935

Në prioritetin e parë hyn dhe rrjeti i rrugëve lokale të këtyre vendbanimeve:

Nr.	Emrat e rrugëve	Gjatësia
1	f Kosovrast i Epërm	4500
2	f Mogorcë	4000
3	f. Banjishtë	2500
4	f. Otishan	1500
	Gjithsejt	12.500

## 2.Prioriteti i dytë

Në prioritet e dyta hynë edhe rrugët vijuese :

- pastrimi me kamion me plug dhe derdhje e rizllës me krypë

Nr	Emri i Rrugëve	Gjatësia
1	Rr,,Boris Kidriç ,,	400
2	Rr."Bogomilski pohod"	100
3	Rr."Ilindenska"	170
4	Rr."Nikola Karev"	80
5	Rr."Pitu Guli"	880
6	Rr."Radika"	60
7	Rr"Brigada e 7 Shqipëtare ,,	660
8	Rr ,, Brigada Maqedono-Kosovare ,,	140
9	Rr."Mali Pirin"	140
10	Rr."304"	290
11	Rr."400"	120
	GJITHSEJ	2.240

- Pastrimi me ICB makinë pa hudhje.

Nr	Emri i Rrugëve	Gjatësia
1	Rr"Vidoe Smileski Bato"	150
2	Rr."Ejup Qatipi"	380
3	Rr."Edip Papraniku"	300
4	Rr"Zhivko Bogdanovski"	500
5	Rr ."Zeqir Çanka"	330
6	Rr."Liman Kaba"	600
7	Rr."8 Marsi "	340
8	Rr ,, 29 Nëntori	200
9	Rr ."Tasa Martinovska"	1030
10	Rr."Goce Delcev"	350
11	Rr."Karaorman"	650

**Nr.8/02.12.2013 KUMTESA ZYRTARE E KOMUNËS faq.177**

12	Rr."Korab"	370
13	Rr"Tanas Topalovski"	400
14	Rr."Trajçe Dukoski"	260
	Gjithsejt	6.510

Orarin e pastrimit të rrugëve të prioritetit të dytë e cakton udhëheqësi kujdestar.  
Në prioritetin e dytë hyn dhe rrjeti i rrugëve lokale.

Nr.	Emrat e rrugëve	Gjatësia
1	f Kosovrast i Poshtëm	1500
2	f Osoj	2000
3	f Sollokiç	4500
4	f Spas	2000
5	f. Shullan	2200
6	f. Zepishtë	1000
7	f.Tatar Elevcë	4000
8	f.Hame	1000
9	Rruga e liqenit	2100
10	f Rajçicë e Epërme	2500
11	f Bomovë	3000
	Gjithsej	25.800

Nëse makina e përcaktuar për pastrim në rrugët në prioritetin parë siguron funksionim normal të komunikacionit , atëherë ai drejtohet për pastrimin e rrjetit të rrugëve lokale dhe nëse është e nevojshme aktivizohen marëveshjet e lidhura me operativën ndërtuese.

**3.Prioriteti i tretë**

Në prioritetin e tretë hyjnë rrugët e tjera të mbetura nga qyteti Dibër ku nuk është e mundur të depërton makineria .

Të njëjtat pastrohen nga qytetarët në gjërësi të hapësirave të oboreve në kordinim me bashkësitë lokale .

Oboret e objekteve afariste do të pastrohen nga vetë ata .

Hapësirat në dhe përreth objekteve të shkollave pastrohen në mënyrë të organizuar nga nxënësit dhe udhëheqësit e klasëve.

Trotuaret para hapësirave afariste do të pastrohen nga ana e pronarëve në gjërësi të trotuareve .

Urat për këmbësorë me trotuarë dhe trotuaret pa hapësirë afariste do ti pastrojë NPK ,, Standard ,, e organizuar sipas programës së saj .

Vërejtje:

Largimi i borës do të bëhet kur trashësia e saj është 5 cm. Në trashësi më të vogël të borës do të intervenohet me hudhje të krypës dhe rrërës.

Rrugët e prioritetit të parë duhet të përgatiten për komunikacion deri më orën 05:00.

Programi hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të shpallet në Kumtesën zyrtare të Komunës Dibër.

**Nr.07-1097/5**  
**29.11.2013**  
**D i b ë r**

**KËSHILLI I KOMUNËS**  
**Kryetari,**  
**Bashkim Mashkulli d.v.**

**K O N K L U Z I O N**  
**Nr.08- 1125/3 dt. 02.12.2013**  
**PËR SHPALLJE TË VENDIMIT PËR SJELLJEN E**  
**PLANIT DETAL URBANISTIK PËR PJESËN QËNDRORE**  
**TË QYTETIT , LOKALITETI „ VENEC 2 ”**  
**PJESË TË BLOKUT – 12 , 13 dhe 14 KOMUNA DIBËR**

117.Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),  
Kryetari i Komunës Dibër:

**K o n k l u d o i**

SHPALLET vendimi për sjelljen e Planit Detal Urbanistik për pjesën Qëndrore të qytetit , lokaliteti „ Venec 2 ” pjesë të bllokut – 12 , 13 dhe 14 Komuna Dibër, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e tetë dt.29.11.2013.

**KOMUNA DIBËR**  
**Kryetari,**  
**Ruzhdi Lata d.v.**

**V E N D I M**

**Nr.07-1097/6 dt. 29.11.2013**

**PËR SJELLJEN E PLANIT DETAL URBANISTIK  
PËR PJESËN QËNDRORE TË QYTETIT , LOKALITETI „ VENEÇ 2 ”  
PJESË TË BLOKUT – 12 , 13 dhe 14 KOMUNA DIBËR**

**118.**Në mbështetje të nenit 26, paragrafi 5 alinea 2 të Ligjit për planifikim hapsinor dhe urbanistik (“Gazeta zyrtare RM-së” nr. 51/05, 137/07, 91/09, 124/10, 18/11 53/11, 144/12 dhe 53/13 ), nenit 22, paragrafi 1, pika 1 dhe nenit 36 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, (“Gazeta zyrtare e RM-së nr. 5/02 ) dhe nenit 27 paragrafi 1 pika 7 të Statutit të komunës Dibër, ( “Gazeta zyrtare e komunës Dibër” nr. 14/03 ),

Këshilli i Komunës Dibër në seancën e 8<sup>të</sup> datë 29.11.2013 vendosi:

**Neni 1**

Sjellat **PLANI DETAL URBANISTIK PËR PJESËN QËNDRORE TË QYTETIT , LOKALITETI „ VENEÇ 2 ” PJESË TË BLOKUT – 12 , 13 dhe 14 KOMUNA DIBËR**, me sipërfaqe prej 8.2 ha me kato kufinj: veri – rr. “Boris Kidriq ” dhe rr. “16 “ ( 205), lindje kufiri lindor i parcelave kadastrale nr. 5370,5545 dhe 5546 KK Dibër 1, juglindje qarkorja jugore (R-418- dega) R 1201 dhe jugperëndim rruga e planifikuar “1”.

**Neni 2**

Plani nga neni 1 i këtij Vendimi është i përpiluar nga **ZUAS- Shkup me nr. teknik 2439/12**, i cili përmban pjesën tekstuale dhe grafike.

**Neni 3**

Plani verifikohet në afat prej 8(tetë) ditësh nga dita e miratimit në 7 (shtatë) ekzemplarë dhe ju dërgohen shërbimeve përkatëse.

**Neni 4**

Planin do ta zbatojë organi kompetent i Komunës Dibër

**Neni 5**

Ky Vendim me një ekzemplar të verifikuar të Planit i dorëzohet Organit të administratës shtetërore kompetente për punët nga sfera e rregullimit të hapësirës.

**Neni 6**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në “ Gazetën zyrtare të Komunës Dibër”

**KËSHILLI I KOMUNËS**

**Kryetari,**

**Bashkim Mashkulli d.v.**

**K O N K L U Z I O N**  
**Nr.08- 1125/4 dt. 02.12.2013**  
**PËR SHPALLJE TË VENDIMIT PËR PËR SJELLJEN E**  
**PLANIT DETAL URBANISTIK PJESË TË**  
**BLLOKUT – 2, v.q. „NAMAZJAR „ - DIBËR**  
**KOMUNA DIBËR**

**119.**Në mbështetje të nenit 50 të Ligjit për vetadministrimin lokal (“Gazeta zyrtare e RM” nr.5/02) si dhe nenit 45 të Statutit të Komunës Dibër (“Kumtesa zyrtare e Komunës”nr.14/03),  
Kryetari i Komunës Dibër:

**K o n k l u d o i**

SHPALLET vendimi për sjelljen e Planit Detal Urbanistik pjesë të Bllokut -2 v.q. “Namazjar” Komuna Dibër, miratuar nga Këshilli i Komunës në seancën e tetë dt.29.11.2013.

**KOMUNA DIBËR**  
**Kryetari,**  
**Ruzhdi Lata d.v.**

